



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE**



**PROGRAMI I LËNDËS
*Gjuhë Frënge e folur 3(B2-C1)***

Ngarkesa: 4 kredite, 40 orë mësimore në klasë, 40 seminare

Tipologjia e lëndës: (A)

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: (semestri I, viti II)

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Frënge dhe Gjuhën e Shenjave Shqipe

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme lëndore: Të thellojë dhe të përmirësojë njohuri të strukturave gjuhësore të gjuhës frënge në planin leksikor, sintaksor dhe gramatikor. Të zhvillojë aftësitë të vëzhgimit, analizës, shpjegimit, reagimit dhe përmbledhjes, si strategji të të nxënit që do të çojnë në mënyrë progresive drejt autonomisë gjuhësore për të shprehur pikëpamje personale për situata të ndryshme.

Objektiva specifike lëndore:

- Të praktikojë dialogë, që na japin një pamje panoramike reale të tingullit të frëngjishtes sot, projektuar të jenë të larmishme, shpesh argëtuese, gjithmonë realiste. Ne kemi unifikuar një gjuhë në funksion të të folurit, shpesh duke përdorur shprehje frazeologjike, dhe ndonjëherë edhe zhargonin, aq të vështirë për t'u zotëruar në një gjuhë të huaj.
- Të praktikojë fjalorin e mësuar dhe përvetësojë fjalorin i ri. Fjalori tematik i përzgjedhur zgjeron bagazhin leksikor të studentëve, vë theksin te praktikimi i gjuhës së folur, te situatat konkrete të komunikimit të përditshëm, real dhe te kodet kulturore të francezëve.
- Të zhvillojë aftësitë për të shprehur me gojë duke zgjedhur dhe përdorur shprehjet dhe strukturat e duhura për të formuluar, argumentuar, shpjeguar dhe arsyetuar një gjykim personal ndaj teksteve të përzgjedhura nga zhanre të ndryshme.

Rezultate të pritshme:

- Përmirëson njohjen e strukturave thelbësore të gjuhës në mënyrë që të thellojë njohuritë gramatikore, semantike dhe ortografike në të folur.
- Kupton, të zbulojë dhe të bëjë kërkime mbi temën e një teksti të shkruar dhe të dije të debatojë duke paraqitur pikëpamjet e tij mbi këtë temë apo edhe në grup.
- Mëson si të formulojmë një gjykim dhe të japë një vlerësimin për tekstin si dhe për opinionet e të tjerëve.
- Zhvillon të menduarit kritik mbi tekstin dhe ideologjitë e të tjerëve.